

**AKT THEMELIMI I
SHOQERISE KONCESIONARE
“LIRIA ENERGJI“ SHPK**

Sot ne date 24/05/2013 (Njzet e kater maj dymije e trembedhete) ne qytetin e Korces duke u bazuar ne vullnetin e tij te lire, te plote dhe te sinqerte ne baze te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “ Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare “ortaku i vetem“ i shoqerise tregtare

Shoqeria tregtare : “Thoreneks“ Sh.p.k regjistruar si person juridik me nr. NIPTI K 24305001Q me seli ne qytetin e Korces, perfaqesuar nga administratori i saj Z. Aurel Xega.

Ka hartuar ketë akt themelimi te kesaj shoqerie koncesionare lidhur me organizimin, administrimin dhe drejtimin e shoqërisë “Liria Energji“ Sh.p.k .

Shoqeria eshte “Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar” ku ortaket mbulojne personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara.

Kjo shoqeri koncesionare po krijohet ne mbeshtetje dhe per zbatimin e kontrates per ndertimin e Hidrocentraleve **Shpella Poshte II & Shpella Poshte III** me nr. 6004 Rep, 1756 Kol date 24 Maj 2013. Ne funksionimin e shoqerise koncesionare do te kihet parasysh te gjitha elementet e percaktuar ne kontraten e mesiperme.

NENI 1

Shoqëria koncesionare do te mbaje emrin “Liria Energji“ Sh.p.k . i cili do te jete i stamposur dhe ne vulën e saj dhe do te figuroje ne te gjitha aktet ose dokumentat e nxjera nga shoqeria dhe qe ju drejtohen te treteve. Per marredheniet e saj me subjekte jashte territorit te Shqiperise, shoqeria do te mbaje te njejtin emërtim me gërma latine.

NENI 2

Selia e shoqerise

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Korces, ne adresen : Rruga kombetare Korce – Bilisht Km 1. Shoqeria mund te krijojë dege dhe filiale ne rrethe te tjera te Shqiperise dhe jashte saj.

NENI 3

Shoqeria tregtare “Liria Energji“ Sh.p.k . eshte subjekt juridik Shqiptar dhe veprimtarine e saj e bazon ne legjislaturen shqiptare dhe kryesisht ne :

- Ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 „Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“

Regjistrimi i saj ne regjistrin tregtar ndodhur ne QKR behet sipas dispozitave te ligjit nr. 9723 date 03/05/2007 “Per qendren kombetare te regjistrimit”.

NENI 4

Personalitetin e saj ligjor Shoqëria e fiton nëpërmjet Vendimit te regjistrimit pranë QKR.

NENI 5

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete 35 vjet. Kohezgjatje e cila nis ne momentin qe ajo regjistrohet ne regjistrin tregtar prane QKR.

NENI 6

Kontributi dhe Kapitali themeltar

Kontributet per themelimin e kesaj shoqerie jane ne lek nga ortaku themelues i shoqerise Personi juridik "Thoreneks" Sh.p.k.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte ne natyre dhe ka vleren 100 000 leke i ndare ne 100 pjese te barabarta me vlere nominale 1 000 leke sejcila.

Kontributi ne kapitalin themeltar eshte ne natyre ne masen e meposhme nga personi juridik ortak :

"Thoreneks" Sh.p.k.	ne masen	100 %
---------------------	----------	-------

Zvogelimi i kapitalit themeltar ne nje shume me te vogel se shuma minimale e parashikuar nga ligji e detyron shoqerine ta plotesoje ate, perndryshe ajo do te shndrohet ne nje forme tjeter ose te priset.

Kontributet ne sherbime nuk mund te shperblehen me pjese ne kapitalin themeltar.

Kontributi ne kapitalin themeltar ne natyre eshte shlyer sipas nenit 68/6 te ligjit 9901.

Ndalohet emetimi i letrave me vlere nga Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar. Po qe se behet nje gje e tille, ky emetim eshte i pavlefshem.

NENI 7

Objekti i shoqerise

Objekti i veprimtarise ekonomike dhe qellimi i shoqerise eshte :

Ndertimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve "Shpella Poshte II & Shpella Poshte III" tek autoriteti kontraktues, ku perfshihet financimin, ndertimi, venia ne pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shperndarja, eksportimi dhe shitja e energjise elektrike.

NENI 8

Asambleja e Pergjithshme

Organi vendimares i shoqerise eshte asambleja e pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thiret nga administratori.

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të ligjit me nr. 9901.

Thirja e asamblese behet me shkrese e cila duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites dhe dergohet me leter rekomande te pakten 7 dite perpara mbledhjes se asamblese.

Cdo mbledhje e thirur ne menyre te parregullt mund te anulohet.

1. Asambleja e pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqerisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj dministratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) cheshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

2. Asambleja e pergjithshme merr vendime per cheshtjet e percaktuara ne shkronjat "e" dhe "ë" te pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së pergjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqerisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Ndryshimet ne statut vendosen nga ortakët qe perfaqesojne te pakten $\frac{3}{4}$ e pjeseve te kapitalit themeltar.

NENI 9

Administrimi

Administratori eshte perfaqesuesi ligjor i shoqerise ndaj te treteve.

Ai ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rethanat.

Shoqeria tregtare "Liria Energji" Sh.p.k. administrohet nga nje person fizik..

Administrator i Shoqerise Tregtare "Liria Energji" Sh.p.k . eshte Nesti Xega, i biri i Jorgjit dhe Liria, i datelindjes 15/04/1971, banues në Korçë, identifikuar me karten e identitetit me nr. 027752346 i cili do te perfaqesoje shoqerine ne te gjitha veprimtarine e saj.

Administratori emerohet per nje periudhe 5 (pese) vjecare me te drejte riperteritje.

Ky akt themelimi i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar u hartua ne 4 kopje, ne gjuhen shqipe dhe nenshkruhet nga perfaqesuesi i personit juridik duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen origjinale dhe vulen ne te gjitha kopjet e tij. Pjese perberese e ketij statuti eshte dhe vendimi i asamblese se ortakut themelues "Thoreneks" Sh.p.k per miratimin e krijimit te kesaj shoqeria dhe caktimin e personit te autorizuar per nenshkrimin e statudit dhe aktit te themelimit te kesaj shoqerie.

**ORTAKU THEMELUES
I SHOQERISE TREGTARE**

"THORENEKS" SH.P.K

